



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

PROJEKTLIGJI PËR PROKURORIN E SHTETIT¹

DRAFT LAW ON STATE PROSECUTOR²

NACRT ZAKONA O DRŽAVNOM TUŽIOCU³

¹ Projektligji për Prokurorin e Shtetit, është miratuar në mbledhjen e 96-të të Qeverisë së Republikës së Kosovës me Vendimin Nr. 05/96, më datë 14.09.2022.

² Draft Law on State Prosecutor, was approved on the 96th meeting of the Government of the Republic of Kosovo, with the Decision No. 05/96, dated 14.09.2022.

³ Nacrt Zakona o Državnom Tužiocu, usvojen je na 96 sednicu Vlade Republike Kosova, sa Odlukom Br. 05/96, datum 14.09.2022.

Kuvendi i Republikës së Kosovës, Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Miraton: LIGJ PËR PROKURORIN E SHTETIT KAPITULLI I DISPOZITAT PËRGJITHSHME Neni 1 Qëllimi Ky ligj rregullon organizimin, juridiksionin, funksionimin, kompetencat dhe detyrat e Prokurorit të Shtetit. Neni 2 Fushëveprimi Dispozitat e këtij ligji zbatohen për Prokurorin e Shtetit.	Assembly of Republic of Kosovo, Pursuant to Article 65 (1) of the Constitution of Republic of Kosovo, Adopts: LAW ON STATE PROSECUTOR CHAPTER I GENERAL PROVISIONS Article 1 Purpose This law regulates the organization, jurisdiction, functioning, competencies, and duties of the State Prosecutor. Article 2 Scope The provisions of this Law apply to the State Prosecutor.	Skupština Republike Kosova, Shodno članu 65 (1) Ustava Republike Kosovo, Usvaja: ZAKON O DRŽAVNOM TUŽIOCU POGLAVLJE I OPŠTE ODREDBE Član 1 Cilj Ovaj zakon uređuje organizaciju, nadležnost, funkcionisanje, ovlašćenja i dužnosti državnog tužioca. Član 2 Delokrug Odredbe ovog zakona primenjuju se na državnog tužioca.
---	--	---

Neni 3 Përkufizimet	Article 3 Definitions	Član 3 Definicije
1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim: 1.1. Prokurori i Shtetit – institucion i pavarur kompetent dhe përgjegjës për ndjekjen e personave të dyshuar për kryerjen e veprave penale dhe veprave të tjera siç ceken me ligj dhe përfshinë si në vijim: Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, Prokurorinë e Apelit, Prokurorinë Speciale, prokuroritë themelore dhe cilado njësi tjetër organizative që mund të krijohet për të ushtruar funksione prokuroriale. 1.2. Kryeprokurori i Shtetit – Kryeprokurori i Shtetit të Republikës së Kosovës si dhe menaxhmenti dhe kreu mbikëqyrës i Prokurorit të Shtetit. 1.3. Kryeprokurori – kreu i zyrës së prokurorit, duke përfshirë Kryeprokurorin e Shtetit. 1.4. Kushtetuta - Kushtetuta e Republikës së Kosovës.	1. The terms used in this Law shall have the following meaning: 1.1. State Prosecutor - the independent institution with authority and responsibility for the prosecution of persons suspected of committing criminal offenses and other acts specified by law and includes the following: The Chief State Prosecutor's Office, the Appellate Prosecution Office, the Special Prosecution Office, the basic prosecution offices and any other organizational unit that may be created to carry out prosecutorial functions. 1.2. Chief State Prosecutor - the Chief State Prosecutor of the Republic of Kosovo and the management and supervisory head of the State Prosecutor. 1.3. Chief Prosecutor – the head of a prosecution office, other than the Chief State Prosecutor. 1.4. Constitution – the Constitution of the Republic of Kosovo.	1. Izrazi upotrebljeni u ovom zakonu imaju sledeće značenje: 1.1. Državni tužilac – nezavisna institucija nadležna i odgovorna za gonjenje lica osumnjičenih za izvršenje krivičnih dela i druga dela utvrđena zakonom, uključujući sledeće: kancelariju Glavnog državnog tužioca, Apelaciono tužilaštvo, Specijalno tužilaštvo, osnovna tužilaštva i bilo koju drugu organizacionu jedinicu koja se može osnovati za vršenje državne tužilačke funkcije. 1.2. Glavni državni tužilac – Glavni tužilac Republike Kosova, kao i rukovodstvo i nadzorni šef Državnog tužioca. 1.3. Glavni tužilac – šef kancelarije tužioca, isključujući glavnog državnog tužioca. 1.4. Ustav – Ustav Republike Kosova.

1.5. Prokuror Special – prokurori i shtetit që shërben në Prokurorinë Speciale, siç përcaktohet në legjislacionin përkatës. 1.6. Këshilli - Këshilli Prokurorial i Kosovës; 1.7. Aftësitë menaxheriale – kuptim i sistemeve për menaxhimin e resurseve dhe financave, aftësi në planifikim dhe organizim, gatishmëri për delegimin e përgjegjësiave si dhe aftësi për t'i lidhur gjërat në kontekst më të gjerë, si dhe artikulimi i planeve afatgjatë të organizatës. 1.8. Integritet personal - ndershmëri intelektuale, fuqi morale dhe sjellje profesionale, ndjenjë të ndershmërisë, besueshmërisë dhe sinqeritetit absolut dhe siguri, sjelljet me përkushtim dhe pajtueshmëri ndaj ligjit dhe kodeve të përgjithshme të mirësjelljes. 1.9. SMIL – Sistemi për menaxhimin informativ të lëndëve. KAPITULLI II PARIMET THEMELORE	1.5. Special Prosecutor – a state prosecutor serving in the Special Prosecution Office as defined in the respective legislation. 1.6. Council - the Kosovo Prosecutorial Council; 1.7. Managerial skills – understanding systems for managing resources and finances, skills in planning and organizing, willingness to delegate responsibilities and the ability to put things in a broader context, as well as articulating the long-term plans of the organization. 1.8. Personal integrity – intellectual honesty, moral strength and professional conduct, sense of honesty, trustworthiness and absolute sincerity and security, behavior of commitment and compliance with the law and general codes of conduct. 1.9. CMIS – The Case Management Information System. CHAPTER II FUNDAMENTAL PRINCIPLES	1.5. Specijalni tužilac – imenovani tužilac koji radi u Specijalnom tužilaštvu, kako je predviđeno važećeg zakonodavstva. 1.6. Savet – Tužilački savet Kosova; 1.7. Menadžerske veštine – razumevanje sistema za upravljanje resursima i finansijama, veštine planiranja i organizovanja, spremnost za delegiranje odgovornosti i sposobnost povezivanja stvari u širi kontekst, kao i artikulisane dugoročnih planova organizacije. 1.8. Lični integritet – intelektualno poštenje, moralna snaga i profesionalno ponašanje, osećaj poštenja, poverenja i apsolutne iskrenosti i sigurnosti, predano ponašanje i poštovanje zakona i opštih kodeksa ponašanja. 1.9. SMIL – Sistem za informaciono upravljanje predmetima. POGLAVLJE II OSNOVNI PRINCIPI
--	--	---

Neni 4 Pavarësia dhe paanshmëria e Prokurorit të Shtetit 1. Prokurori i Shtetit është institucion i pavarur që ushtron funksionet e veta në mënyrë të paanshme. 2. Prokurori i Shtetit dhe secili prokuror para ligjit siguron trajtim të barabartë, objektiv dhe pa paragjykime për të gjithë personat pa asnjë diskriminim në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, besimit fetar, mendimit politik ose tjetër, origjinës kombëtare apo lidhjes me ndonjë komunitet, pronë, gjendje ekonomike dhe sociale, orientim seksual, lindje aftësi të kufizuara ose status tjetër personal. 3. Është e kundërligjshme për cilindo person fizik apo juridik që të ndërhyjë, pengojë, ndikojë apo të përpiqet të ndërhyjë, pengojë apo ndikojë te Prokurori i Shtetit gjatë kryerjes së funksioneve prokuroriale lidhur me cilindo hetim, procedurë apo lëndë individuale.	Article 4 Independence and Impartiality of State Prosecutor 1. The State Prosecutor is an independent institution that exercises its functions in an impartial manner. 2. The State Prosecutor and each prosecutor ensures equal, objective and unbiased treatment for all persons before the law, without any discrimination on the basis of race, color, gender, language, religious belief, political or other opinion, national origin or affiliation with any community, property, economic and social status, sexual orientation, birth disability or other personal status. 3. It shall be unlawful for any natural or legal person to interfere with, obstruct, influence or attempt to interfere with, obstruct or influence the State Prosecutor in the performance of its prosecutorial functions related to any individual investigation, proceeding, or case.	Član 4 Nezavisnost i nepristrasnost državnog tužioca 1. Državni tužilac je nezavisna institucija koja obavlja svoje funkcije na nepristrasan način. 2. Državni tužilac i svaki tužilac pred zakonom obezbeđuje jednak, objektivan i tretman bez predrasuda za sve osobe bez bilo kakve diskriminacije na osnovu rase, boje kože, pola, jezika, verskog uverenja, političkog ili drugog mišljenja, nacionalnog porekla ili pripadnosti bilo koju zajednice, imovine, ekonomskog i društvenog statusa, seksualne orijentacije, rođenja sa invaliditetom ili drugog ličnog statusa. 3. Protivzakonito je i u suprotnosti sa Ustavom za bilo koje fizičko ili pravno lice koje ometa, smeta, utiče ili pokušava da ometa, omeo ili utiče na Državnog tužioca u vršenju svoje tužilačke funkcije koja se odnosi na bilo koju pojedinačnu istragu, postupak ili predmet.
---	--	--

Neni 5 Ushtrimi i funksioneve prokuroriale 1. Në Republikën e Kosovës funksionet prokuroriale ushtrohen vetëm nga prokurorët e autorizuar dhe kompetent të shtetit dhe prokurorët specialë siç përcaktohet në Ligjin përkatës për Prokurorinë Speciale. 2. Një prokuror i shtetit është i autorizuar të iniciojë hetime penale, të paraqesë aktakuzë, të zhvillojë ndjekjen penale apo të kryejë detyra apo funksione të tjera prokuroriale që janë në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Article 5 Exercise of Prosecutorial Functions 1. In the Republic of Kosovo, prosecutorial functions are exercised only by duly authorized and competent state prosecutors and the Special Prosecutors provided for by the respective Law on the Special Prosecution Office. 2. A state prosecutor is duly authorized to initiate a criminal investigation, file an indictment, conduct a prosecution, or perform other duties and functions that are in accordance with legislation in force	Član 5 Vršenje državnih tužilačkih funkcija 1. U Republici Kosovo tužilačke funkcije vrše se samo od strane nadležnih i ovlašćenih tužilaca, uključujući specijalne tužioce kako je utvrđeno posebnim Zakonom o Specijalnom tužilaštvu. 2. Državni tužilac je ovlašćen da pokrene krivičnu istragu, podnese optužnicu, ili obavlja druge funkcije, koje su u skladu sa važećim zakonodavstvom.
Neni 6 Shumëllojshmëria etnike dhe gjinore e Prokurorit të Shtetit Prokurori i Shtetit pasqyron shumëllojshmërinë etnike dhe barazinë gjinore në përputhje me Kushtetutën, legjislacionin në fuqi dhe parimet e pranuara ndërkombëtarisht lidhur me të drejtat e njeriut.	Article 6 Ethnic and Gender Diversity of the State Prosecutor The State Prosecutor shall reflect the ethnic and gender diversity in accordance with the Constitution, applicable legislation and internationally recognized principles of human rights.	Član 6 Etnicka i rodna raznolikost kancelarije državnog tužioca Državni tužilac odražava etničku raznolikost i rodnu ravnopravnost u skladu sa Ustavom, zakonima na snazi i međunarodno prihvaćenim principima u vezi ljudskih prava.
Neni 7 Efikasiteti i Prokurorit të Shtetit Prokurori i Shtetit ushtron funksionet e veta	Article 7 Efficiency of the State Prosecutor The State Prosecutor shall exercise its	Član 7 Efikasnost državnog tužioca Državni tužilac vrši svoje funkcije na

në mënyrë efikase dhe efektive dhe në pajtueshmëri me Kushtetutën, legjislacionin në fuqi dhe parimet e pranuar ndërkombëtarisht për mos-diskriminim, të drejtat e njeriut dhe liritë themelore.	functions in an efficient and effective manner and in accordance with the Constitution, the applicable law, and internationally recognized principles of non-discrimination, human rights, and fundamental freedoms.	efikasan i efektivan nacin u skladu sa Ustavom, važećim zakonodavstvom, I međunarodno priznatim principima nediskriminacije, ljudskih prava i osnovnih sloboda.
KAPITULLI III KOMPETENCAT PËRGJEGJËSITË PROKURORËVE	CHAPTER III DUTIES AND COMPETENCIES OF STATE PROSECUTOR	POGLAVLJE III ZADACI I NADLEŽNOSTI TUŽILACA
Neni 8 Kompetencat dhe përgjegjësitë e prokurorëve	Article 8 Duties and Competencies of the Prosecutors	Clan 8 Zadaci i nadležnosti tužilaca
1. Kompetencat dhe përgjegjësitë e prokurorëve përfshijnë: 1.1. ushtrimin e funksioneve prokuroriale në mënyrë të pavarur, të drejtë, objektive dhe të paanshme dhe të sigurohen që të gjithë personat trajtohen në mënyrë të barabartë para ligjit; 1.2. zbatimin e standardeve më të larta të kujdesit gjatë kryerjes së funksioneve zyrtare; 1.3. sjellje të ndershme dhe profesionale si në jetën personale ashtu edhe profesionale dhe bazuar në legjislacionin	1. The duties and competencies of the prosecutors shall include: 1.1. to exercise prosecutorial functions in an independent, fair, objective and impartial manner and to ensure that all persons are treated equally before the law; 1.2. to exercise the highest standards of care during the performance of official functions; 1.3. to conduct himself or herself honorably and professionally in personal and professional life and pursuant to	1. Dužnosti i nadležnosti tužilaca moraju da sadrže: 1.1. vršenje funkcije gonjenja na nezavisan, fer, objektivan i nepristrasan nacin i da obezbedi da se sva lica tretiraju jednako pred zakonom; 1.2. vršenje najviših standarda zaštite prilikom obavljanja službene dužnosti; 1.3. pošteno i profesionalno ponašanje u licnom i profesionalnom životu u skladu sa važećim zakonodavstvom i

në fuqi dhe kodin e etikës profesionale;	applicable legislation and the code of professional ethics;	kodeksom profesionalne etike;
1.4. ruajtjen e nderit dhe dinjitetit të Prokurorit të Shtetit;	1.4. to maintain the honor and dignity of the State Prosecutor;	1.4. očuvanje časti i dostojanstva državnog tužioca;
1.5. mbrojtjen e të drejtave ligjore të viktimave, dëshmitarëve, dhe të pandehurve;	1.5. to protect the legal rights of victims, witnesses, and defendants;	1.5. zaštita zakonskih prava žrtava, svedoka i okrivljenih;
1.6. ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme juridike për zbulimin e veprave penale dhe të autorëve të krimit si dhe hetimin dhe ndjekjen me kohë të veprave penale;	1.6. to undertake the necessary legal actions for the detection of criminal offences and discovery of perpetrators, and the investigation and prosecution of criminal offences in a timely manner;	1.6. preduzimanje potrebnih pravnih radnji za otkrivanje krivičnih dela i otkrivanje pocinilaca, kao i blagovremenu istragu krivičnih dela;
1.7. marrjen e vendimeve mbi iniciimin, vazhdimin apo ndërprerjen e procedurës penale ndaj personave të dyshuar apo të akuzuar për kryerjen e veprave penale;	1.7. to make decisions on the initiation, continuation or termination of criminal proceedings against persons suspected or accused of committing criminal offences;	1.7. donošenje odluka o pokretanju, nastavku ili prestanku krivičnog postupka protiv osoba osumnjicenih ili optuženih za krivična dela;
1.8. ngritjen e aktakuzave dhe përfaqësimin e tyre para gjykatës;	1.8. to file indictments and represent them before the court;	1.8. podnošenje optužnica i njihovo predstavljanje pred sudom;
1.9. ushtrimin e mjeteve të rregullta dhe të jashtëzakonshme juridike kundër vendimeve gjyqësore;	1.9. to exercise regular and extraordinary legal remedies against court decisions;	1.9. korišćenje redovnih i vanrednih pravnih lekova protiv sudskih odluka;
1.10. bashkëpunimin me policinë, gjykatat dhe institucionet e tjera;	1.10. to cooperate with police, courts, and other institutions;	1.10. saradnju sa policijom, sudovima i drugim institucijama;
1.11. ndërmarrjen e të gjitha veprimeve të tjera të përcaktuara me ligj.	1.11. to undertake all other actions specified by law.	1.11. preduzimanje svih drugih radnji utvrđenih zakonom.

Neni 9 Veprimtaritë parandaluese Prokurori i Shtetit bashkëpunon me institucionet shtetërore dhe subjektet e tjera publike dhe private në aktivitete lidhur me edukimin e shoqërisë me qëllim të ngritjes së njohurisë për legjislacionin përkatës në fuqi dhe parandalimit të veprave penale.	Article 9 Prevention Activities The State Prosecutor shall cooperate with state institutions and other public and private entities in activities directed at the education of society to increase the knowledge for the applicable legislation and prevention of criminal offences.	Clan 9 Preventivne aktivnosti Državni tužilac mora da sarađuje sa državnim institucijama i drugim javnim i privatnim subjektima u aktivnosti usmerenih ka obrazovanju društva sa ciljem podizanja svesti o relevantnom zakonodavstvu na snazi i sprečavanju krivičnih dela.
Neni 10 Bashkëpunimi ndërkombëtar 1. Kryeprokurori i Shtetit, në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë, përcakton protokole dhe procedura për të ngritur bashkëpunimin me autoritetet e shteteve të tjera sa i përket ndjekjeve penale, përmes shkëmbimit të informacionit dhe mënyrave të tjera në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe marrëveshjet ndërkombëtare lidhur me Kosovës dhe vendeve të tjera. 2. Kryeprokurori i Shtetit bashkëpunon me autoritetet dhe subjektet ndërkombëtare.	Article 10 International Cooperation 1. The Chief State Prosecutor, in cooperation with the Ministry of Justice, shall stipulate the protocols and procedures to promote cooperation with the authorities of other countries relating to the prosecution of crimes through exchange of information and other means, in accordance with the applicable legislation and international agreements between Kosovo and other countries. 2. The Chief State Prosecutor shall cooperate with international authorities and entities.	Clan 10 Međunarodna saradnja 1. Glavni državni tužilac u saradnju sa Ministarstvom pravde ce utvrditi protokole i procedure za unapređenje saradnje sa vlastima drugih zemalja o pitanjima koja se odnose na krivično gonjenje krivičnih dela, kroz razmenu informacija i drugih sredstava, u skladu sa važećim zakonodavstvom i međunarodnim sporazumima između Kosova i drugih zemalja. 2. Glavni državni tužilac sarađuje sa međunarodnim organima i subjektima.

Neni 11 Marrëdhëniet me publikun 1. Prokurori i Shtetit i ofron publikut rregullisht informacione lidhur me veprimtaritë e saj. 2. Pavarësisht nga paragrafi 1 i këtij neni, Prokurori i Shtetit nuk ofron asnjë informacion qoftë drejtpërdrejtë apo tërthorazi që do të zbulonte sekretet zyrtare, do të rrezikonte një hetim apo procedurë penale në zhvillim e sipër, do të dëmtonte integritetin, dinjitetin, sigurinë dhe të drejtat mbi privatësinë e cilitdo person, apo që do të shkelte të drejtat e të miturve.	Article 11 Public Relations 1. The State Prosecutor shall regularly provide information about its activities to the public. 2. Notwithstanding paragraph 1 of this Article, the State Prosecutor shall not provide any information directly or indirectly which would disclose official secrets, would jeopardize a pending investigation or criminal proceeding, be harmful to the integrity, dignity, security, and rights to privacy of any persons, or violate the rights of minors.	Član 11 Odnosi sa javnošću 1. Državni tužilac mora redovno da informiše javnost o svojim aktivnostima. 2. Nezavisno od stava 1. ovog člana, državni tužilac ne sme pružiti bilo kakvu informaciju, direktno ili indirektno koja bi bila otkrivanje službene tajne, ugrozila tok istrage ili krivičnog postupka, koja bi bila štetna za integritet, dostojanstvo, bezbednost i prava na privatnost bilo kog lica, ili kršenje prava maloletnika bi ugrozilo tok krivične istrage ili postupak, naškodilo bi integritetu, dostojanstvu, bezbednosti i pravima na privatnost bilo koje osobe ili bi narušilo prava maloletnika.
Neni 12 Ndarja e lëndëve 1. Ndarja e lëndëve për prokuror bëhet përmes SMIL. 2. Në raste specifike, ndarja e lëndëve bëhet në mënyrë manuale, siç parashihet me aktin përkatës nënligjor të nxjerrë nga Këshilli.	Article 12 Case assignment 1. Case assignemnt for prosecutors is done through CMIS. 2. In specific cases, case assignemnt is done manually, as provided by the relevant sub-legal act issued by the Council.	Član 12 Dodela predmeta 1. Dodela predmeta za tužioce se vrši preko ISUP-a. 2. U posebnim slučajevima, dodela predmeta se vrši manuelno, kao što se predviđa relevantnim podzakonskim aktom donetim od strane Saveta.

KAPITULLI IV STRUKTURA ORGANIZATIVE, JURIDIKSIONI DHE KOMPETENCAT E PROKURORIT TË SHETIT Neni 13 Kompetencat dhe Organizimi i Prokurorit të Shtetit 1. Prokuroria e Shtetit në Republikën e Kosovës organizohet dhe funksionon në përputhje me këtë ligj, si dhe me Ligjin përkatës për Prokurorinë Speciale. 2. Prokuroria e Shtetit është kompetente për ndjekjen penale të personave të dyshuar për ndonjë vepër penale, ushtrimin e mjeteve juridike nga kompetenca e tij, si dhe kryen punë të tjera të përcaktuara me ligj. 3. Kompetenca lëndore dhe territoriale e Prokuroritë të Shtetit përcaktohet sipas dispozitave ligjore me të cilat përcaktohet kompetenca e gjykatave, para të cilave i kryejnë autorizimet e veta, nëse me këtë ligj nuk përcaktohet ndryshe. 4. Prokurorinë e Shtetit e përbëjnë:	CHAPTER IV ORGANIZATIONAL STRUCTURE, JURISDICTION AND COMPETENCES OF THE STATE PROSECUTOR Article 13 Competences and Organization of the State Prosecutor 1. The State Prosecution Office in the Republic of Kosovo shall be organized and shall function in accordance with this Law and the respective Law on Special Prosecution Office. 2. The State Prosecution Office has the competence for prosecuting persons suspected of a criminal offence, exercise legal remedies from its competences, and perform other duties foreseen by the Law. 3. The subject-matter and territorial jurisdiction of the State Prosecutor is determined pursuant to the legal provisions of the law which determines the court jurisdiction, before which they perform their powers, unless otherwise determined by this law. 4. The State Prosecution Office consists of:	POGLAVLJE IV ORGANIZACIONA STRUKTURA I NADLEŽNOST DRŽAVNOG TUŽIOCA Član 13 Nadležnosti i organizovanje Državnog Tužilaštva 1. Državno Tužilaštvo u Republici Kosovo se organizuje i funkcioniše u skladu sa ovim Zakonom kao i relevantnim Zakonom o Specijalnom Tužilaštvu. 2. Državno Tužilaštvo je nadležna za krivično gonjenje optuženih lica za neko krivično delo ili za neko drugo delo, ostvarivanje pravnih lekova iz njenih nadležnosti, i obavlja druge poslove utvrđene Zakonom. 3. Predmetne i teritorijalne nadležnosti Državnog Tužilaštva se utvrđuje prema zakonskim odredbama sa kojim se utvrđuje nadležnost sudova, pred kojim obavljaju svoja ovlašćenja, ukoliko ovim Zakonom nije utvrđeno drugačije. 4. Državno Tužilaštvo čine:
--	---	---

4.1. Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit; 4.2. Prokuroria e Apelit, e cila përbëhet nga Departamenti i Përgjithshëm, Departamenti për të Mitur dhe Departamenti për Krime të Rënda; 4.3. Prokuroria Speciale, siç është e përcaktuar me ligjin përkatës për Prokurorinë Speciale; dhe 4.4. Prokuroritë Themelore të përbëra nga Departamenti i Përgjithshëm, Departamenti për të Mitur dhe Departamenti për Krime të Rënda. 5. Funksionet prokuroriale në zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit i kryen Kryeprokurori i Shtetit dhe prokurorët në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi. 6. Funksionet prokuroriale në Prokurorinë e Apelit dhe në Prokuroritë Themelore i kryejnë kryeprokurorët dhe prokurorët e këtyre prokurorive, në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi.	4.1. the Office of the Chief State Prosecutor; 4.2. Appellate Prosecution Office, which consists of the General Department, Juvenile Department and the Department for Serious Crimes; 4.3. the Special Prosecution Office, as defined by the relevant law on Special Prosecution Office; and 4.4. Basic Prosecution Offices consisting of the General Department, Juvenile Department and the Serious Crimes Department. 5. Prosecutorial functions in the Chief State Prosecutor's Office are performed by the Chief State Prosecutor and prosecutors in the Office of the Chief State Prosecutor, in accordance with the relevant legislation in force. 6. Prosecutorial functions in the Appellate Prosecution Office and the Basic Prosecution Offices are performed by the Chief Prosecutors and prosecutors of these offices, in accordance with the relevant legislation in force.	4.1. Kancelarija Glavnog Državnog Tužioca; 4.2. Apelaciono Tužilaštvo, koja je u sastavu Opšteg odeljenja, Odeljenja za maloletnike i Odeljenja za Teška Krivična Dela. 4.3. Specijalno Tužilaštvo, kako je definisano relevantnim zakonom o Specijalnom tužilaštvu; i 4.4. Osnovna tužilaštva sastavljene od Opšteg Odeljenja, Odeljenja za maloletnike i Odeljenja za teška krivična dela. 5. Tužilačke funkcije u kancelariji Glavnog državnog tužioca obavlja Glavni Državni Tužilac i Tužioci u Kancelariji Glavnog Državnog Tužioca, u skladu sa zakonodavstvom na snazi. 6. Tužilačke funkcije u Apelacionom tužilaštvu i osnovnim tužilaštvima obavljaju glavni tužioci i tužioci ovih tužilaštava, u skladu sa relevantnim zakonima na snazi.
---	--	--

Neni 14 Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit 1. Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit është instanca më e lartë e Prokuroritë të Shtetit me kompetencë në tërë territorin e Republikës së Kosovës, siç përcaktohet me këtë ligj. 2. Selia e Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit është në Prishtinë. 3. Në kuadër të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit funksionon edhe Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave si zyrë e pavarur për ofrimin e shërbimeve për viktimat e krimit gjatë procedurave ligjore dhe përfaqësimit të interesave të tyre në sistemin e drejtësisë penale. 4. Mandati, struktura, funksionimi dhe organizimi i Zyrës për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave rregullohet me akte nënligjore të miratuara nga Këshilli.	Article 14 Office of the Chief State Prosecutor 1. The Office of the Chief State Prosecutor is the highest instance of the State Prosecutor with authority throughout the territory of the Republic of Kosovo as defined by this Law. 2. The seat of the Office of the Chief State Prosecutor is in Prishtina. 3. Within the Office of the Chief State Prosecutor functions the Victims Advocacy and Assistance Office as an independent office for providing services to victims of crime during legal procedures and representing their interests in the criminal justice system. 4. The mandate, structure, operation and organization of the Victims Advocacy and Assistance Office is regulated by sub-legal acts approved by the Council.	Član 14 Kancelarija glavnog državnog tužioca 1. Kancelarija Glavnog Državnog Tužilaštva je najviša instanca Državnog Tužilaštva sa nadležnostima na celoj teritoriji Republike Kosovo kako je utvrđeno ovim zakonom. 2. Sedište Kancelarije Glavnog Državnog Tužilaštva je u Prištini. 3. U okviru Kancelarije Glavnog državnog tužioca, funkcioniše i Kancelarija za zaštitu i pomoć žrtvama kao nezavisna kancelarija za pružanje usluga žrtvama krivičnih dela tokom sudskih postupaka i zastupanje njihovih interesa u sistemu krivičnog pravosuđa. 4. Mandat, struktura, rad i organizacija Kancelarije za zaštitu i pomoć žrtvama uređuju se podzakonskim aktima koje usvaja Savet.
Neni 15 Prokuroria e Apelit 1. Prokuroria e Apelit vepron dhe përfaqëson lëndët në Gjykatën e Apelit si dhe ka kompetenca të tjera të përcaktuara me ligj.	Article 15 Appellate Prosecution Office 1. The Appellate Prosecution Office acts and represents cases before the Court of Appeals, and has other powers defined by law.	Član 15 Apelaciono tužilaštvo 1. Apelaciono tužilaštvo postupa i zastupa pred apelacionim sudovima kao i da ima druga ovlašćenja definisana zakonom.

2. Prokuroria e Apelit ka juridiksion në tërë territorin e Republikës së Kosovës. 3. Me pëlqimin e Kryeprokurorit të Prokurorisë së Apelit, prokurori që ka vepruar në shkallë të parë në një lëndë konkrete mund ta shoqërojë dhe ndihmojë prokurorin e Prokurorisë së Apelit në seancën e shkallës së dytë në mbrojtjen apo kundërshtimin e ankesës. 4. Selia e Prokurorisë së Apelit është në Prishtinë.	2. The Appellate Prosecution Office has jurisdiction in the entire territory of the Republic of Kosovo. 3. With the consent of the Chief Prosecutor of the Appellate Prosecution Office, the prosecutor who has acted in the first instance in a particular case may accompany and assist the prosecutor of the Appellate Prosecution Office in the second instance session in defending or opposing the appeal. 4. The seat of the Appellate Prosecution Office is in Prishtina.	2. Apelacionim tužilaštvom rukovodi Glavni tužilac, imenovan prema Zakonu o Tužilačkom savetu Kosova. 3. Uz saglasnost glavnog tužioca Apelacionog tužilaštva, tužilac koji je postupao u prvom stepenu u konkretnom slučaju može pratiti i pomagati tužiocu Apelacionog tužilaštva u drugostepenoj sednici u odbrani ili protivljenju žalbe. 4. Sedište kancelarije apelacionog tužilaštva je u Prištini.
Neni 16 Prokuroria Speciale 1. Prokuroria Speciale është organ prokurorial i specializuar, me juridiksion në tërë territorin e Republikës së Kosovës, siç përcaktohet me legjislacionin në fuqi. 2. Juridiksioni territorial, fushëveprimi, kompetenca lëndore e Prokurorisë Speciale, funksionet procedural dhe përbërja e Prokurorisë Speciale përcaktohen me Ligjin përkatës për Prokurorinë Speciale.	Article 16 Special Prosecution Office 1. The Special Prosecution Office is a specialized prosecutorial body, with jurisdiction throughout the territory of the Republic of Kosovo, as defined by the legislation in force. 2. The territorial jurisdiction, scope, subject-matter competence of the Special Prosecution Office, procedural functions and composition of the Special Prosecution Office are defined in the relevant Law on the Special Prosecution Office.	Član 16 Specijalno tužilaštvo 1. Specijalno tužilaštvo je specijalizovani tužilački organ, sa jurisdikcijom na celoj teritoriji Republike Kosova, kako je utvrđeno važećim zakonodavstvom. 2. Mesna nadležnost, delokrug, stvarna nadležnost Specijalnog tužilaštva, procesne funkcije i sastav Specijalnog tužilaštva definišu se odgovarajućim Zakonom o Specijalnom tužilaštvu.

Neni 17 Prokuroria Themelore	Article 17 Basic Prosecution Office	Član 17 Osnovno tužilaštvo
1. Prokuroria Themelore ka juridiksion mbi të gjitha lëndët e shkallës së parë, përveç nëse është paraparë ndryshe më ligj. 2. Prokuroria Themelore ka juridiksion territorial të përcaktuar si në vijim: 2.1. Prokuroria Themelore në Prishtinë, për territorin e Gjykatës Themelore të Prishtinës, siç përcaktohet në Ligjin përkatës për Gjykatat; 2.2. Prokuroria Themelore në Ferizaj, për territorin e Gjykatës Themelore të Ferizajit, siç përcaktohet në Ligjin përkatës për Gjykatat; 2.3. Prokuroria Themelore në Gjakovë, për territorin e Gjykatës Themelore të Gjakovës, siç përcaktohet në Ligjin përkatës për Gjykatat; 2.4. Prokuroria Themelore në Gjiilan, për territorin e Gjykatës Themelore të Gjiilanit, siç përcaktohet në Ligjin përkatës për Gjykatat; 2.5. Prokuroria Themelore në Mitrovicë, për territorin e Gjykatës Themelore të Mitrovicës siç përcaktohet	1. The Basic Prosecution Office shall have jurisdiction over all first instance cases, unless otherwise provided by law. 2. The Basic Prosecution Office has the territorial jurisdiction defined below: 2.1. Basic Prosecution Office in Prishtina, for the territory of the Basic Court of Prishtina as provided in the respective Law on Courts; 2.2. Basic Prosecution Office in Ferizaj, for the territory of the Basic Court in Ferizaj as provided in the respective Law on Courts; 2.3. Basic Prosecution Office in Gjakova, for the territory of the Basic Court in Gjakova as provided in the respective Law on Courts; 2.4. Basic Prosecution Office in Gjiilan, for the territory of the Basic Court in Gjiilan as provided in the respective Law on Courts; 2.5. Basic Prosecution Office in Mitrovica, for the territory of the Basic Court in Mitrovica as provided in the	1. Osnovno tužilaštvo imaće jurisdikciju nad prvostepenim predmetima ukoliko drugačije nije propisano zakonom. 2. Osnovno tužilaštvo ima mesnu nadležnost definisanu na sledeći način: 2.1. Osnovno tužilaštvo u Prištini, za teritoriju Osnovnog suda u Prištini kao što je propisano u relevantnom Zakonu o sudovima; 2.2. Osnovno tužilaštvo u Uroševcu, za teritoriju Osnovnog suda u Uroševcu kao što je propisano u relevantnom Zakonu o sudovima; 2.3. Osnovno tužilaštvo u Đakovici, za teritoriju osnovnog suda u Đakovici kao što je propisano u relevantnom Zakonu o sudovima; 2.4. Osnovno tužilaštvo u Gnjilane, za teritoriju osnovnog suda u Gnjilane kao što je propisano u relevantnom Zakonu o sudovima; 2.5. Osnovno tužilaštvo u Mitrovici, za teritoriju Osnovnog suda u Mitrovici kao što je propisano u relevantnom Zakonu o

në Ligjin përkatës për Gjykatat; 2.6. Prokuroria Themelore në Pejë, për territorin e Gjykatës Themelore të Pejës, siç përcaktohet në Ligjin përkatës për Gjykatat; 2.7. Prokuroria Themelore në Prizren, për territorin e Gjykatës Themelore të Prizrenit siç përcaktohet në Ligjin përkatës për Gjykatat.	respective Law on Courts; 2.6. Basic Prosecution Office in Peja, for the territory of the Basic Court in Peja as provided in the respective Law on Courts; 2.7. Basic Prosecution Office in Prizren, for the territory of the Basic Court in Prizren as provided in the Law on Courts.	sudovima; 2.6. Osnovno tužilaštvo u Peći, za teritoriju osnovnog suda u Peci kao što je propisano u relevantnom Zakonu o sudovima; i 2.7. Osnovno tužilaštvo u Prizrenu, za teritoriju Osnovnog suda u Prizrenu kao što je propisano u relevantnom Zakonu o sudovima;
Neni 18 Themelimi i zyrove tjera 1. Kryeprokurori i Shtetit mund t'i paraqet kërkesë Këshillit për themelimin e zyrove të tjera në kuadër në sistemit prokurorial. 2. Në rast së Këshilli miraton themelimin e një zyre tjetër, atëherë do t'i paraqesë Kuvendit të Republikës së Kosovës propozim për plotësim buxhetor.	Article 18 Establishment of Other Offices 1. The Chief State Prosecutor may submit to the Council a request to establish other offices within the prosecutorial system. 2. If the Council approves the establishment of another office, it shall present to the Assembly of Republic of Kosovo a proposal for budgetary supplement.	Član 18 Osnivanje drugih kancelarija 1. Glavni državni tužilac može podneti zahtev Savetu za osnivanje drugih kancelarija u tužilačkom sistemu. 2. Ako Savet odobri osnivanje druge kancelarije, mora predstaviti Skupštini Republike Kosova predlog za dopunu budžeta.
Neni 19 Bashkëpunëtorët profesional të Prokurorive dhe Praktikantët 1. Për kryerjen e përgjegjësiave të tyre, çdo prokuror duhet të ketë së paku një bashkëpunëtor profesional.	Article 19 Professional associates and Interns of Prosecution Offices 1. For the performance of their responsibilities, each prosecutor shall have at least one professional associate.	Član 19 Stručni saradnici tužilaštava i pripravnici 1. Za izvršavanje svojih obaveza, svaki tužilac treba da ima najmanje jednog profesionalnog saradnika.

2. Këshilli Prokurorial i Kosovës me akt nënligjor përcakton procedurën e përzgjedhjes dhe emërimit, kriteret, të drejtat dhe detyrimet për bashkëpunëtorë profesional dhe praktikantë. KAPITULLI V KOMPETENCAT DHE PËRGJEGJËSITË E KRYEPROKURORIT TË SHETIT, KRYEPROKURORËVE, ZËVENDËS- KRYEPROKURORIT TË SHETIT, ZËVENDËS- KRYEPROKURORËVE DHE UDHËHEQËSVE TË DEPARTAMENTEVE Neni 20 Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Kryeprokurorit të Shtetit 1. Kryeprokurori i Shtetit është kreu i Prokurorit të Shtetit dhe ka këto kompetenca dhe përgjegjësi: 1.1. Është përgjegjës për menaxhimin dhe përfaqësimin e Prokurorit të Shtetit dhe të strukturave të prokurorive, të	2. The Kosovo Prosecutorial Council with a sub-legal act determines the selection and appointment procedure, criteria, rights and obligations for professional associates and interns. CHAPTER V COMPETENCES AND RESPONSIBILITIES OF THE CHIEF STATE PROSECUTOR, CHIEF PROSECUTORS, DEPUTY CHIEF-PROSECUTOR, DEPUTY CHIEF- PROSECUTORS AND HEADS OF DEPARTMENTS Article 20 Competences and Responsibilities of the Chief State Prosecutor 1. The Chief State Prosecutor is the head of the State Prosecutor and has these competencies and responsibilities: 1.1. Is responsible for the management and representation of the State Prosecutor and the structures of the	2. Tužilački savet Kosova podzakonskim aktom utvrđuje postupak izbora i imenovanja, kriterijume, prava i obaveze stručnih saradnika i pripravnika. POGLAVLJE V NADLEŽNOSTI I ODGOVORNOSTI GLAVNOG DRŽAVNOG TUŽIOCA, GLAVNIH TUŽILACA, ZAMENIKA GLAVNOG TUŽIOCA, ZAMENIKA GLAVNOG DRŽAVNOG TUŽIOCA I RUKOVODILACA ODELJENJA Član 20 Nadležnosti i odgovornosti glavnog državnog tužioca 1. Glavni državni tužilac je rukovodilac državnog tužioca i ima ove nadležnosti i odgovornosti: 1.1. Odgovoran je za upravljanje i zastupanje Državnog tužilaštva i struktura tužilaštva koje čine Državno
---	---	--

cilat e përbëjnë Prokurorinë e Shtetit; 1.2. Është anëtar sipas detyrës zyrtare i Këshillit; 1.3. I rekomandon Këshillit emërimin e Zëvendës-Kryeprokurorit të Shtetit, nga radhët e prokurorëve në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit; 1.4. Mund t'i paraqesë Këshillit propozim për shkarkim të Zëvendës-Kryeprokurorit të Shtetit dhe Kryeprokurorit të prokurorisë përkatëse; 1.5. Ka kompetencë ekskluzive për lëndët në shkallë të tretë pranë Gjykatës Supreme dhe mbi të gjitha lëndët që përfshijnë mjetet e jashtëzakonshme juridike; 1.6. Nxjerr me shkrim rregulla, udhëzime dhe vendime të përgjithshme të detyrueshme për të gjithë kryeprokurorët dhe prokurorët me qëllim të zbatimit të ligjshmërisë, ngritjes së efikasitetit dhe zbatimit unik të praktikave dhe legjislacionit; 1.7. Mbikëqyr zbatimin e udhëzimeve	prosecution offices, which constitute the State Prosecution; 1.2. Is an ex-officio member of the Council; 1.3. Makes recommendation to the Council for appointment of the Deputy Chief State Prosecutor, among the prosecutors in the Office of the Chief State Prosecutor; 1.4. May submit to the Council a proposal for dismissal of the Deputy Chief State Prosecutor and the Chief Prosecutor of the relevant prosecution office; 1.5. Has exclusive jurisdiction of cases at the third instance before the Supreme Court and for all cases involving extraordinary legal remedies; 1.6. Issues in writing mandatory rules, instructions and general decisions for all chief prosecutors and prosecutors in order to implement legality, increase efficiency and unique implementation of practices and legislation; 1.7. Oversees the implementation of	tužilaštvo; 1.2. Član Saveta je po službenoj dužnosti; 1.3. Daje preporuku Savetu za imenovanje zamenika-glavnog državnog tužioca, među tužiocima u kancelariji Glavnog državnog tužioca; 1.4. Može da podnese Savetu predlog za razrešenje zamenika-glavnog državnog tužioca i glavnog tužioca nadležnog tužilaštva; 1.5. Ima isključivu nadležnost za predmete u trećem stepenu pred Vrhovnim sudom i za sve predmete koji uključuju vanredne pravne lekove; 1.6. Izdaje u pismenoj formi obavezna pravila, uputstva i opšte odluke za sve glavne tužioce i tužioce u cilju sprovođenja zakonitosti, povećanja efikasnosti i jedinstvene primene prakse i zakonodavstva na snazi; 1.7. Nadzire sprovođenje smernica i
---	---	--

dhe akteve tjera të përcaktuara me legjislacionin në fuqi; 1.8. I propozon Këshillit për miratim rregullat mbi veprimtarinë dhe udhëheqjen e evidencës në Prokurorin e Shtetit; 1.9. Mund t'u jap udhëzime me shkrim Kryeprokurorit të një prokurorie apo cilido prokuror të ndonjë prokurorie për punën konkrete, me qëllim të zhvillimit efikas të procedurës ose për arsye tjera të rëndësishme kur konsideron se ka neglizhencë, paaftësi profesionale apo mos zbatim të ligjshmërisë. Udhëzimet duhet të jenë të arsyetuara dhe të mos e cenojnë pavarësinë funksionale dhe profesionale të prokurorëve; 1.10. Mund të kërkojë raporte apo informata tjera me shkrim lidhur me progresin, gjendjen apo zgjidhjen e lëndëve të caktuara. Kërkesa e tillë duhet të bëhet me shkrim; 1.11. Bën vlerësimin e punës së Kryeprokurorëve dhe prokurorëve në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit; 1.12. Kërkon vlerësimin e	instructions and other acts defined by legislation in force; 1.8. Proposes to the Council for approval the rules on the activity and management of record-keeping in the State Prosecutor; 1.9. May give written guidelines to the Chief Prosecutor of a prosecution office or to any prosecutor of any prosecution office for the specific work, for the purpose of efficient development of the proceedings or other important reasons, when he considers that there is negligence, professional incompetence or failure to implement legality. The guidelines must be reasoned and not infringe the functional and professional independence of prosecutors; 1.10. May request reports or other written information regarding the progress, status or resolution of certain cases. Such request shall be made in writing; 1.11. Appraises the work of Chief Prosecutors and Prosecutors in the Office of the Chief State Prosecutor; 1.12. Requests the extraordinary	drugih akata definisanih zakonom; 1.8. Predlaže Savetu usvajanje pravila o radu i vođenju evidencije u kancelariji državnog tužioca; 1.9. Može dati pismena uputstva glavnom tužiocu tužilaštva ili bilo kom tužiocu bilo kog tužilaštva za konkretan rad, radi efikasnijeg odvijanja postupka ili iz drugih važnih razloga kada smatra da postoji nemar, stručna nesposobnost ili ne sprovođenje zakonitosti, uputstva moraju biti obrazložena i da ne narušavaju funkcionalnu i profesionalnu nezavisnost tužilaca; 1.10. Može zahtevati izveštaje ili druge pisane informacije u vezi sa napretkom, stanjem ili rešavanjem određenih slučajeva. Takav zahtev se podnosi u pismenoj formi; 1.11. Ocenjuje rad glavnih tužilaca i tužilaca u kancelariji Glavnog državnog tužioca; 1.12. Zahteva vanredno ocenjivanje
--	--	--

jashtëzakonshëm të Kryeprokurorëve dhe prokurorëve në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit; 1.13. Kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me ligj. 2. Me qëllim të zhvillimit efikas të procedurës ose për arsye tjera të rëndësishme, Kryeprokurori i Shtetit në bazë të një vendimi me shkrim, mund të marrë nën juridiksion cilindo rast në cilëndo prokurori në Republikën e Kosovës, ose ta ri-caktoj atë te një prokurori tjetër. Përveç elementeve të përmendura, një vendim i tillë duhet të arsyetojë së paku neglizhencën, paaftësinë profesionale ose konfliktin e interesit që e bëjnë të besueshëm një vendim të tillë. Neni 21 Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Kryeprokurorëve 1. Kryeprokurori ka këto kompetenca dhe përgjegjësi: 1.1. Udhëheqë me punën dhe përfaqëson prokurorinë për të cilin është emëruar; 1.2. Është përgjegjës për punën e prokurorisë dhe për punën e vet për	appraisal of Chief Prosecutors and prosecutors in the Office of the Chief State Prosecutor; 1.13. Performs other tasks as defined by law. 2. For the purpose of efficient conduct of the procedure or for other important reasons, the Chief State Prosecutor, based on a written decision, may take jurisdiction over any case in any prosecution office in the Republic of Kosovo, or re-assign it to an other prosecution office. In addition to the elements mentioned, such a decision shall at least justify the negligence, professional incompetence or conflict of interest which make such a decision credible. Article 21 Competences and Responsibilities of Chief Prosecutors 1. The Chief Prosecutor has these competencies and responsibilities: 1.1 Administers the work and represents the prosecution for which he has been appointed; 1.2 Is responsible for the work of the prosecution, and for his work on	glavnih tužilaca i tužilaca u kancelariji glavnog državnog tužioca; 1.13. Obavlja i druge poslove utvrđene zakonom. 2. U cilju efikasnog vođenja postupka ili iz drugih važnih razloga, glavni državni tužilac, na osnovu pismene odluke, može preuzeti nadležnost za svaki predmet u bilo kom tužilaštvu u Republici Kosovo, ili ga ponovo dodeliti nekom drugom tužiocu. Pored navedenih elemenata, takva odluka će barem opravdati nemar, profesionalnu nesposobnost ili sukob interesa koji takvu odluku čine verodostojnom. Član 21 Nadležnosti i odgovornosti glavnih tužilaca 1. Glavni tužilac ima ove nadležnosti i odgovornosti: 1.1. Rukovodi radom i zastupa tužilaštvo za koje je imenovan; 1.2. Odgovoran je za rad tužilaštva i za svoj rad u upravnim stvarima, odgovara
---	---	---

çështje administrative i përgjigjet Këshillit, ndërkaq për çështje operative i përgjigjet Kryeprokurorit të Shtetit;	administrave matters is accountable before the Council whereas for operational matters is accountable before the Chief State Prosecutor;	Savetu, dok o operativnim pitanjima odgovara Glavnom državnom tužiocu;
1.3. I rekomandon Këshillit Zëvendës-Kryeprokurorin e tij;	1.3 Recommends to the Council his Deputy Chief Prosecutor;	1.3 Preporučuje Savetu svog zamenika glavnog tužioca;
1.4. Mund t'i paraqesë Këshillit propozim për shkarkim të Zëvendës-Kryeprokurorit të tij;	1.4 May submit to the Council a proposal for dismissal of his Deputy Chief Prosecutor;	1.4. Može da podnese Savetu predlog za razrešenje svog zamenika glavnog tužioca;
1.5. Mund të merr përsipër funksionin e ndjekjes penale në një lëndë konkrete që i është caktuar një prokurori vartës në atë prokurori me pëlqimin paraprak të Kryeprokurorit të Shtetit. Marrja e rastit duhet të bëhet me vendim të arsyetuar dhe të bëhet përshtatshmërisht për rrethanat e përcaktuara në nenin 20, paragrafi 2 të këtij ligji;	1.5 May take over the function of criminal prosecution in a concrete case assigned to a subordinate prosecutor in that prosecutor's office with the prior consent of the Chief State Prosecutor. The taking of the case shall be done with a reasoned decision and appropriately for the circumstances defined in Article 20, paragraph 2 of this Law;	1.5. Može preuzeti funkciju krivičnog gonjenja u konkretnom predmetu dodeljenom podređenom tužiocu u tom tužilaštvu uz prethodnu saglasnost Glavnog državnog tužioca. Preuzimanje predmeta vrši se obrazloženom odlukom i da se izvrši mutandis sa okolnostima utvrđenim u članu 20, stav 2 ovog zakona;
1.6. mund të kërkojë raporte me shkrim apo informata nga prokurori vartës;	1.6 may request written reports or information from the subordinate prosecutor;	1.6. može tražiti pismene izveštaje ili informacije od podređenog tužioca;
1.7. mund të delegojë disa kompetenca tek vartësit e tij;	1.7 may delegate some competencies to his subordinates;	1.7.može delegirati neke nadležnosti svojim podređenim;
1.8. Mund t'u jap udhëzime me shkrim prokurorëve të një prokurorie që udhëheq, me qëllim të zbatimit të	1.8. May give written guidelines to the prosecutors of the prosecution office he leads, in order to enforce legality, increase efficiency and uniquely	1.8.Može da daje pismena uputstva tužiocima tužilaštva koju vodi, u cilju sprovođenja zakonitosti, povećanja

ligjshmërisë, ngritjes së efikasitetit dhe zbatimit unik të praktikave dhe legjislacionit. Udhëzimet duhet të jenë të arsyetuara, të mos cenojnë pavarësinë funksionale dhe profesionale të prokurorëve. Nëse prokurori e konsideron udhëzimin si të kundërligjshëm ose në kundërshtim me ndërgjegjshmërinë e tij, ai ka të drejtë të kërkojë vendimin e Kryeprokurorit të Shtetit. Vendimi i Kryeprokurorit të Shtetit është me shkrim dhe përfundimtar. 1.9. Bën vlerësimin e punës së prokurorëve të prokurorisë që udhëheq; 1.10. Kërkon vlerësimin e jashtëzakonshëm të performancës së prokurorëve të prokurorisë që udhëheq; 1.11. Kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me ligj. 2. Përveç kompetencave dhe përgjegjësi të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, Kryeprokurori i Prokurorisë Speciale si dhe Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Prishtinë i propozon Këshillit caktimin dhe shkarkimin e udhëheqësve të departamenteve siç përcaktohet me këtë ligj.	implement practices and legislation. The guidelines must be reasoned and not infringe the functional and professional independence of prosecutors. If the prosecutor considers the guidelines to be unlawful or contrary to his conscientiousness, he has the right to request the decision of the Chief State Prosecutor. The decision of the Chief State Prosecutor is made in writing and is final. 1.9. Appraises the work of the prosecutors of the prosecution office he leads; 1.10. Requests the extraordinary performance appraisal of the prosecutors of the prosecution office he leads; 1.11. Performs other tasks defined by law. 2. In addition to the competencies and responsibilities defined in paragraph 1 of this Article, the Chief Prosecutor of the Special Prosecution Office as well as the Chief Prosecutor of the Basic Prosecution in Prishtina proposes to the Council the appointment and dismissal of heads of departments as defined by this law.	efikasnosti i jedinstvene primene praksi i zakona. Uputstva treba da budu obrazložene, da ne narušavaju funkcionalnu i profesionalnu nezavisnost tužilaca. Ako tužilac smatra da je uputstvo nezakonito ili protivno njegovoj savesti, on ima pravo da traži odluku Glavnog državnog tužioca. Odluka Glavnog državnog tužioca je pismena i konačna.; 1.9. Ocenjuje rad tužilaca tužilaštva koju vodi; 1.10. Zahteva vanrednu procenu učinka rada tužilaca tužilaštva koju vodi; 1.11. Obavlja i druge poslove utvrđene zakonom. 2. Pored nadležnosti i odgovornosti utvrđenih u stavu 1. ovog člana, Glavni tužilac Specijalnog tužilaštva kao i glavni tužilac Osnovnog tužilaštva u Prištini predlaže Savetu imenovanje i razrešenje rukovodilaca odeljenja u skladu sa ovim zakonom.
--	--	--

